

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E ENJTE 21 KORRIK 2022

Përshëndetje!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë, që po ndiqni këtë seancë,

Sot maxhoranca do të kalojë, me fuqinë e kartonëve, zgjatjen e moratoriumit të gjuetisë. Prej shkurtit të vitit 2014, kur u vendos moratoriumi prej kësaj qeverie dhe deri më sot, në vendin tonë mbi 15 mijë gjuetarë, të anëtarësuar në Federatën e Gjuetarëve të Shqipërisë, e kanë të ndaluar këtë aktivitet, i cili, përveçse argëtues, përfaqëson, njëkohësisht, edhe traditën dhe pasionin e tyre. Shqipëria është i vetmi vend në rajon dhe, ndoshta, në Europë, e cila është kaq e kujdesshme ndaj faunës, por kaq e paaftë për të monitoruar territorin dhe ndëshkuar shkelësit e ligjit, kaq e zonja për të maskuar pas moratoriumit arsyet e vërteta të vendosjes së tij.

Personalisht dhe shumica e shqiptarëve jemi të bindur se moratoriumi, në fakt, nuk u duhet shqiptarëve. Moratoriumi ju duhet juve, moratoriumi i duhet Edi Ramës, për të vazhduar i qetë kanabizimin e vendit, të nisur prej vitit 2013 në çdo cep të territorit të Shqipërisë, duke e ruajtur hera-herës këtë gjë edhe me uniformat, të cilat, në fakt, duhet ta godasin atë. Të gjithë e kujtojmë që vetëm disa muaj pas hyrjes në fuqi të moratoriumit të gjuetisë, në maj të vitit 2014, në Divjakë, në bregdetin e saj, u rrëzua një avion i vogël, me një pilot, që shkonte në drejtim të paditur. Në fakt, u konfirmua që ishte për transport të lëndëve narkotike dhe avionë të tjerë të tillë, të ngjashëm, u shtuan dhe u gjendën në çdo cep të territorit të Shqipërisë dhe mbinë si kërpudhat pas shiut, menjëherë pas moratoriumit.

Në zonën e parkut në Divjakë, në një zonë të mbrojtur, që ju e keni kaq për zemër, po ashtu, dëshmojnë banorët, në zona pak të frekuentuara, se në hyrje të tyre qëndronin dikur uniforma policie, të cilat ndalonin qarkullimin e njerëzve të paktë që mund t'u binte rruga për të kaluar,

ose edhe për të shkuar në arat e tyre. Në fakt, nëse këto pretendime të banorëve qëndrojnë, ngrenë mjaft dyshime që këto uniforma mund të ishin aty për ruajtjen e parcelave të kanabisit, që, sikurse në Divjakë, edhe në shumë zona të tjera të mbrojtura, jam e bindur që këto vite kanë lulëzuar prej kësaj qeverie.

Një aspekt tjetër i këtij moratoriumi, i zgjatur, i përsëritur tashmë dhe sot për të tretën herë është duke vrarë në një periudhë 10-vjeçare, që ju pretendoni me këtë 3-vjeçar shtesë, traditën e zonave të caktuara, siç është Divjaka, të cilat kanë një komunitet të konsiderueshëm gjuetarësh dhe gjuetinë e kanë konsideruar ndër shekujsh si sport, pasion dhe dikur edhe mënyrë jetese. Personalisht, ju siguroj se kjo zonë, që kam nderin të përfaqësoj në Kuvendin e Shqipërisë, e ka mbrojtur pyllin, florën, faunën e Divjakës në nivele të admirueshme, në fakt, dhe fakti që sot është ndër zonat më të paprekura, e dëshmon më së miri, pa dashur të justifikoj apo të mbroj asnjë abuzues, apo shkelës ligji, për të cilin duhet të veprojë ligji dhe vetëm ligji, ai ligj që ju nuk arrini dot ta formuloni, ta monitoroni dhe ta zbatoni.

Pashë me mjaft interes disa vende të rajonit dhe të Europës dhe mënyra e konceptimit të ligjit të gjuetisë është pak a shumë e njëjtë, e përafërt me ligjin e gjuetisë, që ka ekzistuar para vendosjes së moratoriumit në Shqipëri, por që kishte vend për rregullime dhe korrigjime dhe këtë gjë duhet ta kishit bërë ju. Gjuetia nuk është krim dhe asnjë vend në Europë nuk e koncepton si krim. Ndalimi i saj, në emër të kanabizimit, po, ky është krim. Zeroni çdo të ardhur nga gjuetia e ndershme, nga licencat që gjuetarë të ndershëm, që duan ta ushtrojnë këtë lloj sporti, hobi, pasioni, në fakt, jeni duke sjellë një term të ri, “bird watching”, pra “vrojtimi i zogjve” dhe thoni që ne kemi të ardhura të mëdha në ekonomi nga njerëz që vijnë në Shqipëri, vetëm për të parë zogj. Jam e sigurt që asnjë shqiptar nuk e beson, madje, as ju vetë nuk e besoni këtë gjë.

Në të gjitha vendet fqinje, në vendet e rajonit, ligji funksionon me kufizime, patjetër, me një kalendar të specieve, të cilat mund të jenë ose jo, objekt i gjuetisë së ligjshme dhe periudhat përkatëse të gjuetisë. Individët që duhet ta ushtrojnë, duhet të kenë disa kritere: një moshë të caktuar mbi 18 vjeç; të kalojnë në teste teorike dhe praktike përpara se të pajisen me licencë; të japin garanci se kanë aftësi mendore dhe fizike dhe njohuritë për të përdorur një armë gjahu.

Pra, duhet të kalojnë në disa teste paraprake, përpara se të pajisen me të drejtën për ta ushtruar, në mënyrë të ligjshme, këtë pasion të tyre.

Nga ana tjetër, moratoriumi i vendosur prej jush ka bërë që, në fakt, të lulëzojë gjatë gjithë kësaj periudhe gjuetia e paligjshme. Ndërkohën të ligjshmit, ndërkohën të ndershmit, lulëzon gjuetia e paligjshme, kudo në territorin e Shqipërisë. Pak a shumë, me këto që demonstrova, arrij në përfundimin se vendet me një qeverisje të përgjegjshme nuk privojnë qytetarët, por kontrollojnë respektimin e ligjit dhe për më tepër që ju nuk kemi asnjë të dhënë faktike për situatën e faunës, si ka qenë, si është sot, cili ka qenë rezultati i moratoriumit? Ju thoni se kemi pasur sukses në vendosjen e moratoriumit, ndalimin e gjuetisë, ndërkohë sot pretendoni se duhet ta zgjasim edhe për 5 vjet dhe tashmë, pas diskutimeve në komision, për 3 vjet.

Në rast se kemi pasur sukses këta 7 vjet, sot duhej ta hiqim moratoriumin dhe duhej të diskutonim për një ligj të mirëfilltë, të plotë të gjuetisë. Në fakt, këto të dyja, pra sukcesi i moratoriumit të 7 vjetëve dhe zgjatja e tij, sepse kemi sërish nevojë, bien ndesh me njëra-tjetrën dhe nuk shkojnë dot përkrah, siç ju po i vendosni. Personalisht, edhe kolegët e opozitës do të votojmë kundër moratoriumit të gjuetisë, sepse nuk mbron faunën, por veç kanabizimin që ju i bëtë Shqipërisë prej vitit 2013 dhe vazhdoni sërish në çdo cep të saj, sepse privon traditën, pasionin dhe të drejtën kushtetuese të njerëzve të përgjegjshëm ndaj natyrës dhe faunës për ta ushtruar hobin dhe pasionin në mënyrë të ndershme. Por ju doni ta ndëshkoni për shkak të paaftësisë suaj ndershmërinë, duke lejuar abuzuesit dhe abuzivitetin. Ju faleminderit!